

# PLANI ZHVILLIMOR I SHKOLLËS (PZHSH)


2021



Sho fotografinë e shkollës.

## Kalendari i planifikimit

Grafiku më poshtë tregon se si kalendari i planifikimit për Planin e Zhvillimit të Arsimit në Komunë lidhet me kalendarin e veprimëve në nivelin e shkollave dhe atë kombëtar, dhe si të gjitha janë të lidhura me ciklin e buxhetit.



Emri i shkollës: Pjetër Bogdani

Vendi: Prishtinë

Komuna: Prishtinë

PZhSh dhe rishikimi i aprovuar nga: KDSH - EVV

Data e aprovimit: 02.10.2021

Data e rishikimit (të ardhshëm): 28.02.2022

Nënshkruar nga Kryetari i KDSH:

## **PËRMBAJTJA E PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS**

<b>I. Të dhënat për shkollën .....</b>	<b>3</b>
1.1. Përshkrimi/pasqyrimi i shkurtër i të dhënave të shkollës .....	3
1.2. Përmbledhje e të dhënave në bazë të shkollës.....	4
1.3. Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit) .....	5
1.4. Suksesi i nxënësve sipas lëndëve – mesatarja e suksesit për vitin e fundit shkollor dhe krahasimi me vitin paraprak .....	6
1.5. Mungesat e nxënësve dhe braktisja .....	8
<b>II. Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike .....</b>	<b>9</b>
2.1. Vizioni dhe misioni.....	9
<b>III. Fazat e hartimit të Planit Zhvillimor të Shkollës .....</b>	<b>10</b>
3.1 Fazat e hartimit të planit zhvillimor të Shkollës.....	10
3.2. Lista e kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën për një periudhë 3 vjeçare .....	11
3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës .....	12
3.4. Objektivat zhvillimore të shkollës.....	17
<b>IV. PLANI I MENAXHIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS – PLANI TRE VJEÇAR.....</b>	<b>18</b>
4.1. Prioritet e përzgjedhura – arsyeshmëria.....	18
4.2. Pasqyra e planit tre vjeçar.....	19
<b>V. PLANI VJETOR I SHKOLLËS .....</b>	<b>20</b>
5.1. Tabela e prioriteteve .....	20
5.2. Monitorimit dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Shkollës .....	23
5.3. Aktivitete të tjera .....	26
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>27</b>



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### 1.1. Përshkrimi/pasqyrimi i shkurtër i të dhënave të shkollës

Veçoritë dhe profili i shkollës:

Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Pjetër Bogdani" në Prishtinë është themeluar më 28 maj 1962, ku kishte një numër të madh të nxënësve. Struktura nacionale në atë kohë ka qenë e përzier, ku mësimi është zhvilluar në dy gjuhë: gjuhën shqipe dhe gjuhën serbo-kroate. Tani mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe.

Në shkollë vijnë mësimin 537 nxënës, 47 punëtorë, prej tyre gjithsej 37 mësimdhënës. Institucioni disponon një hapësirë të brendshme dhe të jashtme që është i përshtatshëm me numrin e nxënësve të cilin e disponon shkolla.

Shkolla "Pjetër Bogdani", kishte paralelen e ndarë në Kolovicë, e cila për disa vite kishte një numër shumë të vogël të nxënësve, më saktësisht në vitin 2016/17 kishte vetëm 2 nxënës në klasë të kombinuara, një mësuese klasore dhe një mësimdhënëse të gjuhës angleze, por tani kjo paralele është mbyllur.

Institucioni udhëhiqet dhe menaxhohet nga drejtori i shkollës dhe sekretarja, të cilët bashkëveprojnë me të gjithë akterët dhe këshillet e shkollës, të cilët janë funksionale gjatë gjithë vitit. Në shkollë rol të veçantë ka psikologjia e shkollës, e cila punon momentalisht në dy shkolla.

Mësimdhënësit janë të kualifikuar dhe të trajnuar për punën edukativo-arsimore. Mësimdhënësit janë të interesuar dhe vazhdimisht në kërkim të zhvillimit profesional për t'u përgatitur, për t'u përballuar me sfidat që sjellë zbatimi i Kurrikulit të Ri të Kosovës i bazuar në kompetenca, si dhe përmbushin e ambicjet tyre për të avancuar në karrierë.

Në shkollë janë funksionale aktivitetet profesionale dhe vlen të veçohet një bashkëpunim i mirëfilltë mes anëtarëve të aktiveve profesionale si dhe aktiveve në përgjithësi mes tyre. Bordi drejtues i shkollës është funksional dhe vepron sipas udhëzimeve adekuate.

Shkolla jonë është institucion gjithëpërfshirës e cila, veprimtarinë e vet e realizon në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të moshës parafillore, fillore dhe të mesme të ulët.

Në shkollën tonë gjithashtu përfshihet mësimi inkluziv me fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e grupeve të marginalizuara apo pafavorizuara pa dallim etnie apo kulture. Bëhet përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë, gjithashtu zhvillojmë te nxënësi respektin për mjedisin dhe respektohen maksimalisht të drejtat e të gjithëve.

Shkolla jonë inkurajon krijimtarinë dhe promovon diversitetin. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me shkollat tjera, ku ka një etikë të fortë, të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin. Këshilli i prindërve është funksional dhe shumë aktiv në të gjitha fushat e interesit të realizimit sa më të mire të të gjithë proceseve të shkollës



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### 1.2. Përmbledhje e të dhënave bazë të shkollës

Viti shkollor: 2021/22 <sup>1</sup>

Nr.	Kategoria	Përshkrimi	Koment shtesë
1.	Numri i nxënësve	Gjithsej: 537	
2.	Numri i mësimdhënësve	Gjithsej: 37	
3.	Numri i mësonjëtove	18	
4.	Numri i klasave	28	
5.	Anëtarë i Komunitetit të të Mësuarit së bashku:	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	2 nx. të komunitetit RAE, por të regjistruar me kombësi s
6.	Internet dhe wireless	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	Interneti është mundësuar nga DKA
7.	Dollapë për nxënës	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	30
8.	Qasje për personat me aftësi të kufizuara	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	Qasja është vetëm në hyrje të shkollës
9.	Ngrohja	Qendrore me pelet	
10.	Kushtet sanitare:	Të mira	DKA dhe Kompania Krasniqi
11.	Furnizim i rregullt me ujë:	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	Por, sistemi i ujit është i vjetër nga viti 1962 dhe vazhdi
12.	Tualetet (të ndara për meshkuj dhe femra)	<input checked="" type="radio"/> Brenda <input type="radio"/> Jashtë	2 për femra, 2 për meshkuj dhe 1 për stafin
13.	Çanta e ndihmës së parë	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
14.	Pajisjet e zjarrit në shkollë	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
15.	EPRBM <sup>2</sup>	<input checked="" type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
16.	Objektet përcjellëse	Nuk ka	
17.	Paralelet e ndara	Kolovicë	Është mbyllur

<sup>1</sup> Kjo tabelë azhurohet çdo vit shkollor dhe vendoset në web faqe të shkollës

<sup>2</sup> Ekipi i Parandalim dhe Reagimit ndaj Braktisjes dhe Mos regjistrimit



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Drejtori i shkollës

## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### 1.3. Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit)<sup>3</sup>

Klasa	Viti shkollor 2019/2020 (çdo vit) Viti paraprak shkollor			Viti shkollor i tanishëm 2020/2021 Fundi i vitit shkollorë		
	Të planif. P1	Të mbajtura M1	Ndryshimi N1=(P1-M1)	Të planif. P2	Të mbajtura M2	Ndryshimi N2=(P2-M2)
I	2272	2272		1773	1764	9
II	2298	2251	47	1755	1752	3
III	2527	2492	35	1776	1776	0
IV	2640	2584	56	1818	1815	3
V	2757	2751	6	1830	1824	6
VI	3148	3907	51	2490	2464	26
VII	3525	3520	5	2650	2637	13
VIII	4386	4349	3.7	2686	2563	23
IX	3078	3061	17	2502	2478	19
X						
XI						
XII						
<b>Gjithsej</b>	26631	26377	254	19280	19073	207

#### Shkalla e përmbushjes:

1. Mesatarja e orëve të mbajtura=Shuma(P1-M1):Shuma (P1) 26631-26377=254

2. Mesatarja e orëve të mbajtura=shuma(P2-M2):Shuma (P2)  
19280-19073=207



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. <sup>3</sup> Tabela e buxhetit në fund të çdo viti shkollor.  
Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### 1.4. Suksesi i nxënësve sipas lëndëve<sup>4</sup>

Kosova për herë të parë merr pjesë në testin PISA (Programi ndërkombëtarë për vlerësim të nxënësve) ku vlerësohen nxënësit e moshës 15 vjeçare në matematikë, shkencë dhe lexim. Për ta përcjellë me vëmendje të shtuar performancën dhe rezultatet e nxënësve në këto lëndë nga drejtorët e shkollave kërkohet të analizojnë suksesin e arritur të studentëve çdo vit shkollor duke e krahasuar me suksesin e vitit paraprak.

Për të pasur një pasqyrë reale të rezultateve shkollat duhet të shtojnë rezultatet nga vlerësimi i jashtëm të shkollës së tyre, nëse nuk është e mundur atëherë ata duhet të shfrytëzojnë rezultatet nga testi i kaluar nga niveli komunal.

Shkollat, sipas nevojave dhe interesave, mund të raportojnë edhe për lëndët tjera mësimore duke shtuar rreshta të rinjë në këtë tabelë.

#### Suksesi në Nivelin I – KSNA I (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) Klasa V

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmë vjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Mesatarja kombëtare nga suksesi i fundit (testi i kl V) <sup>5</sup>	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	V	3.7	4.66	4.64		57	0
Matematikë	V	4.44	4.56	4.50		57	0
Shkencat e natyrës	V	4.54	4.67	4.60		57	0

<sup>4</sup> Suksesi i paraqitur në këto tabela azhurnohen çdo vit shkollor dhe vendoset në web faqe të shkollës.

<sup>5</sup> Lidhja me Divizionin për vlerësim standarde dhe monitorim (DVSM)



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Drejtori i  
shkollës

## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### Suksesi në Nivelin II – KSNA II (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) klasa IX

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmë vjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Suksesi mesatar nga vlerësimi i jashtëm (semimatura)	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	IX	3.48	3.55	3.52		77	0
Matematikë	IX	2.70	3.08	2.89		77	0
Shkencat e natyrës	IX	3.03	3.33	3.18		77	0

### Suksesi në Nivelin III – KSNA III (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) klasa XII

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmë vjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Suksesi mesatar nga vlerësimi i jashtëm (Matura)		Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II		Afati i parë	Afati i dytë		
Gjuhë amtare	XII							
Matematikë	XII							
Shkencat e natyrës	XII							
Totali i përgjithshëm nga të gjitha lëndët	XII							





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



Drejtori i  
shkollës

## I. TË DHËNAT PËR SHKOLLËN

### 1.5. Mungesat e nxënësve dhe braktisja

#### Mungesat e nxënësve nga vitit shkollor paraprak

Klasa	Me arsye	Pa arsye	Mesatarja e mungesave për nxënës	Numri më i madh i mungesave për një nxënës
1-5	893	4	3.03	
6-9	1782	452	8.55	
10-12				
<b>Total</b>	2675	456	11.99	

#### Braktisja e nxënësve

Nxënësit që kanë lëshuar shkollën	Nxënësit kanë ndërruar shkollën, kanë konfirmuar dhe dokumentuar regjistrimin e tyre	Numri neto i nxënësve që e kanë braktisur shkollën
A	B	A-B
0	22	0



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## II. VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni dhe misioni i shkollës: Pjetër Bogdani

**Vizioni:** (deklarata e vizionit – “ëndrra realiste”)

(Deklarata e vizionit duhet të bazohet në fushat e cilësisë – përkatësisht vizioni i shkollës për arritjen/ avancimin e fushave të cilësisë gjatë një periudhe 10 vjeçare)

### VIZIONI

Çdo klasë me nxënës hulumtues, mësimdhënës kreativ dhe inovativ.

**Misioni:** (deklarata e misionit – Si ta arrijmë këtë ëndërr realiste)

(Deklarata e misionit duhet të bazohet në fushat e cilësisë – përkatësisht misioni i shkollës për arritjen/ avancimin e fushave të cilësisë gjatë një periudhe 10 vjeçare)

### MISIONI

Do të përkushtohemi në ofrimin e një mësimdhënie efektive që do të përmbush potencialin arsimor dhe social duke ofruar mjedis të përshtatshëm për hulumtim që do t'i bënte nxënësit dhe mësimdhënësit që procesin mësimor ta përjetojnë si kënaqësi shpirtërore e emocionale.



**SHËNIM:** Kandidatët të cilët kandidohen për herë të parë për pozitën e udhëheqësit të institucionit edukativo arsimor (iea) e plotësojnë pzhsh deri këtu. Pjesa tjetër e pzhsh plotësohet pasi kandidati të jetë zgjedhur drejtues i iea.





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

#### 3.2. Lista e kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën për një periudhë 3 vjeçare

Udhëzimet dhe sqarimet e detajuara për përdorim të kësaj table janë dhënë në Modulin III – Plani Zhvillimor i Shkollës. Nëse keni bërë vetëvlerësim ju duhet ta shfrytëzoni atë për të identifikuar aspektet relevante, shiko shtojcën 2 të bashkangjitu.

	FUSHAT E CILËSISË SË SHKOLLËS	Zgjedhë aspektet relevante të kriterëve të cilësisë me interes të veçantë për shkollën
A	MENAXHIMI DHE QEVERISJA	<p>Organet drejtuese të shkollës do të orientohen në zhvillim të bashkëpunimit me institucione profesionale vendore dhe ndërkombëtare, publike dhe private në arritjen e vizionit dhe misionit të shkollës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Trajtime adekuate për personelin udhëheqës të shkollës si dhe anëtarët e rinjë të KDSH, jo domesdoshmërisht të certifikuar.</li> <li>- Organet profesionale jane ristrukturuar, por duhet te fuqizohen</li> </ul>
B	KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Diversiteti, pranueshmëria, mendimet e ndryshme dhe aktivitetet e tjera e dallojnë shkollën tonë për vlerat bashkëkohore të cilat i posedon.</li> <li>- Shkolla jonë do të bëjë përpjekje që nxënësve t'iu ofrojë mjedis atraktiv, miqësor dhe të shëndetshëm për realizimin e të nxënësve efektiv, duke lehtësuar qasjen e personave me nevoja të vecanta (si me pjerrina), duke trajnuar personelin dhe stafin teknik për</li> </ul>
C	MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	<p>Shkolla promovon gjithëpërfshirjen e te gjithë aktoreve te shkolles (menaxhment, mësimdhënës, prind, nxënës).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimi dhe procesi mësimor kurrikular dhe ekstrakurrikular do të mundësojnë dhe do të përkrahin nxënësit për zotërimin e kompetencave duke përdorur metodat dhe strategjitë bashkëkohore.</li> <li>- Përmbytjet mësimore do të mundësojnë zbatimin e dijeve dhe</li> </ul>
D	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	<p>Menaxhmenti i shkolles në mënyrë të vazhdueshme monitoron performancën e mësimdhënësve, ka përpiluar PZHPM nga PIZHPM si dhe shfrytëzon burimet njerëzore për të ofruar trajnime me bazë në shkollë si dhe shfrytëzon gjitha resurset e tjera me qëllim të ngritjes profesionale te mesimdhenesve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësve t'u ofrohen trajnime adukate për vlerësimin për nxënie dhe vlerësimin përmbledhës,</li> </ul>
E	PERFORMANCA E NXËNËSVE	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezultatet e nxënësve dhe të të nxënësve përmblen nga pritshmëritë e përmbytjeve mësimore dhe hulumtimeve te vazhdueshme.</li> <li>- Nxënësit janë të përfshirë në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, klube dhe organizata te ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.</li> <li>- Nxënësit promovojnë gjithëpërfshirje përmes përgjegjesive të</li> </ul>



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

#### 3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

Shto aspektet nga tabela 3.1

Udhëzimet dhe sqarimet e detajuara për përdorim të kësaj tablele janë dhënë në Modulin III – Plani Zhvillimor i Shkollës.

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
A	<p>MENAXHIMI DHE QEVERISJA</p> <p>1. Implementimi dhe monitorimi i KK-së</p> <p>2. Perforcimi i aktiveve profesionale</p> <p>Fuqizimi i organeve përfaqësuese të shkollës</p> <p>4. Trajnime adekuate për personelin dhe KDSH ( anëtarët e rinjë)</p>	<p>1.DKA vazhdon procesin e implementimit të kurrikullit të ri.</p> <p>2. Organet profesionale në bazë të fushës dhe shkollës janë funksionale.</p> <p>3. Organe funksionale si: Këshilli drejtues, Këshilli i prindërve, Këshilli i arsimtarëve dhe Këshilli i nxënësve</p> <p>4. Ngritja profesionale dhe rritje e efikasitetit dhe performancës së KDSH-së</p>	<p>1. Vështirësi në harmonizimin e teksteve më KK-në dhe vlerësimi sipas KK-së.</p> <p>2. Mungon analiza dhe përcaktimi i objektivave tek disa aktive profesionale</p> <p>3. Moskordinimi i faktorit kohë mes organeve funksionale të shkollës.</p> <p>4. Mungesa e përvojës, kapacitetit profesional dhe akademik.</p>	<p>1.Organizohen në vazhdimësi sesione informimi (takimet me SHB) lidhur me implementimin e KK-së.</p> <p>2. Aktivitetet profesionale kanë mundësi të fuqizohen ne paraqitjen e objektivave, prioritetet dhe duke bërë analizën e tyre.</p> <p>3. Vetëdijësimi dhe përpilimi i planit të veprimit si dhe respektimi i detyrave të deleguara.</p> <p>4. Transmetimi i njohurive të anëtarëve të tjerë të shkollës, rritje e vetëdijes për funksionim, funksionim në grup.</p>	<p>1.Rreziku nga ndryshimet, rezistenca ndaj tyre si dhe reflektimi i rezultateve të KK-së në praktikë si dhe situata pandemike.</p> <p>2. Neglizhimi i orarit të takimeve dhe mos respektimi i planit të veprimit në aktive.</p> <p>3. Inkorporimi i individëve të cilët nuk kanë vullnet dhe aftësi për kryerjen e detyrave.</p> <p>4. Manipulimi dhe shfrytëzimi i hapësirave ligjore dhe neglizhimi i takimeve.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### 3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
<b>B</b>	<p><b>KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR</b></p> <p>1. Lehtësimi i qasjes së personave me nevoja të veçanta .</p> <p>2. Trajnimi i personelit dhe stafit teknik për evakuim emergjent dhe sigurimi i shkollëve emergjente.</p> <p>3. Rregullimi i këndit të lojërave për grup moshat parafillor, si dhe rregullimi i klasës verore në oborrin e shkollës - Sigurimi i zhvështoreve.</p> <p>4. Organizimi i Ditës së Shkollës dhe festave të ndryshme. -Mirëmbajtja e web-faqes së shkollës dhe rrjeteve sociale.</p>	<p>1. Hapësirat e mjaftueshme për intervenim</p> <p>2. Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme, rritje e motivit dhe dëshirës për intervenim në situata emergjente si dhe posedimi i rregullorës për evakuim.</p> <p>3. Hapësira të mjaftueshme për rregullimin e këndit të gjelbërt, këndit të lojërave si dhe klasës verore që të ndërlihet mësimi teorik me atë praktik.</p> <p>4. Inkurajimi i punës në grupe dhe rritja e statifikacionit të mësimit dhe nxënësve dhe</p>	<p>1. Mungesa e dizajnit të planit dhe buxhetit.</p> <p>2. Personel i patrajnuar dhe mungesa e planit të veprimit për evakuim.</p> <p>3. Mungesa e këndit të veçantë dhe mjeteve konkretizuese për nxënësit parafillor. Zona gjelbëruese të pamjaftueshme dhe mungesa e zhvështoreve. Ambienti jo i përshtatshëm për hyrje dalje të fëmijëve për grupmosha të ndryshme.</p> <p>4. Mungesa e mjeteve financiare dhe hapësirës jo të mjaftueshme për realizimin e organizimeve.</p>	<p>1. Identifikimi i donatorëve për realizimin e pjerrinave.</p> <p>2. Kërkesa për trajnime të stafit për evakuim emergjent si dhe përpilimi i planit të veprimit.</p> <p>3. Egziston mundësia për rregullimi i këndit të lodrave dhe këndit të veçantë për gjelbrim. Dy hapësira të tualeteve të shndërrohen në zhvështore.</p> <p>4. Ofrimi i ideve kreative nga mësuesit dhe prindërit për realizimin e aktiviteteve dhe mirëmbajtjen e rrjeteve sociale.</p>	<p>1. Mosgatishmëria e dhënies së donacioneve nga jashtë.</p> <p>2. Papërgjegjëshmëria , mosrespektimi i detyrave nga personat përgjegjës. dhe mungesa e shkollëve emergjente</p> <p>3. Keqpërdorimi dhe dëmtimi eventual i këndeve të gjelbërta. Nderhyrja ne infrastrukturën e shkollës.</p> <p>4. Bashkëpunimi në nivel jo të duhur.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritetet kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### 3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
C	<p><b>MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA</b></p> <p>1. Mësimdhënie dhe nxënie bashkëkohore duke zhvilluar mësim hulumtues dhe praktik, përmes përdorimit të TIK-ut dhe burimeve tjera.</p> <p>2. Përfshirja e nxënësve në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare.</p> <p>3. Organizimi dhe pjesëmarrja në gara, kuize të ndryshme si në shkollë, po ashtu edhe jashtë shkollës</p>	<p>1. Mësimdhënës dhe nxënës të interesuar dhe kreativ. Posedimi i platformës "E-shkollori", në shkollë.</p> <p>2. Planifikimi i aktiviteteve kurrikulare dhe ekstrakurrikulare.</p> <p>3. Nxënës të interesuar dhe mësimdhënës të përkushtuar për arritjen e suksesit.</p>	<p>1. Mungesa e mjeteve dhe hapësirave të mjaftueshme. Mungesa e paisjeve dhe internetit në cdo klasë.</p> <p>2. Mungesa e interesimit të mjaftueshëm nga një numër i nxënësve si dhe mjetet e pamjaftueshme financiare për realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare.</p> <p>3. Hapësira të pamjaftueshme për zhvillimin e mësimin shtues dhe plotësues në të njëjtën kohë për të gjitha lëndët.</p>	<p>1. Zhvillim bashkëkohor dhe produkt i kompletuar i dijes konkurrent me vendet e rajonit, duke përdorur format e ndryshme të hulumtimit për përpilimin e projekteve lëndore.</p> <p>2. Promovimi i aktiviteteve të organizuara mbrenda dhe jashtë shkollës si dhe realizimi i aktiviteteve përmes KMB</p> <p>3. Organizimi i testeve të brendshme të shkollës, kuizeve si dhe mësimi shtues/plotësues të organizohet në formën e rotacionit, i cili ka në fokus përgatitjen e nxënësve për garat e diturisë.</p>	<p>1. Keqpërdorimin i faqeve të ndryshme në internet në rast të mungesës së monitorimit nga mësimdhënësit.</p> <p>2. Mosrespektimi i planit të veprimit për vizita.</p> <p>3. Keqpërdorimi i orarit pas mësimin nga ana e nxënësve.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### 3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
D	<p><b>ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE</b></p> <p>1. Trajnimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve në zbatimin e metodologjive të reja.</p> <p>2. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve dhe monitorimi i ndërsjelltë.</p> <p>3. Organizimi i hulumtimeve lëndore dhe mbështetja për realizimin e tyre</p>	<p>Shkolla posedon PIZHPM dhe PZHPM, ku ka identifikuar nevojat për trajnim. Ekipi për zhvillimin profesional të mësimdhënësve do të organizojë trajnime me bazë në shkollë.</p> <p>2. Mësimdhënës të trajnuar, rritje të përgjegjësisë dhe efikasitetit në punë.</p> <p>3. Mësimdhënës të kualifikuar dhe të interesuar për hulumtime lëndore. Shkolla ka udhëzuesin për HV.</p>	<p>1. Kemi një numër të vogël të mësimdhënësve të cilët janë fasilitator të certifikuar.</p> <p>2. Mos përditësimi i planifikimeve të planprogrameve dhe mosshfrytëzimi i TIK-ut, rezistenca e pranimi të vlerësimeve.</p> <p>3. Jo të gjithë janë të trajnuar për Hulumtimin në Veprim.</p>	<p>1. Të përcillen njoftimet në nivel komunal dhe ministror, në organizimin e trajnimeve të ndryshme në programe relevante, në mënyrë që mësimdhënësve t'u ofrohen trajnime adekuate.</p> <p>2. Seanca diskutim, trajnime me bazë në shkollë si dhe përdorimi i TIK-ut.</p> <p>Identifikimi i mësimdhënësve që kanë nevojë për zhvillim profesional, si dhe bashkëpunimi ndërkolegial më qëllim të shkëmbimit të metodologjisë së punës më nxënës.</p> <p>3. Mbajtja e trajnimeve me bazë në shkollë, DKA, MASHT dhe organizata të ndryshme.</p>	<p>1. Mësimdhënës që hezitojnë dhe nuk pranojnë zhvillim profesional (mosha para pensionit).</p> <p>2. Mungesa e njohurive për përdorimin e TIK-ut.</p> <p>3. Mësimdhënës që hezitojnë të bëjnë hulumtime lëndore .</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rumbullako të paktën tri prioritete kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.





**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### 3.3. Analiza e gjendjes në fusha të cilësisë së shkollës – analiza SWOT

	Fushat e cilësisë së shkollës	Përparësitë/ Sukseset	Mangësitë/ Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
E	<p><b>PERFORMANCA E NXËNËSVE</b></p> <p>1. Pjesëmarrja e nxënësve në proceset demokratike të shkollës si dhe inkurajimi i diversitetit.</p> <p>2. Matja e performancës përmes testimit të brendshëm, kuizeve dhe rezultateve të garave të ndryshme.</p> <p>3. Pjesëmarrje aktive në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare</p> <p>4. Ushtrimi i përgjegjësive sociale e qytetare në klasë dhe fuqizimi i punës vullnetare të shkollës.</p>	<p>1. Toleranca mes nxënësve të cilët janë përgjegjës që t'i kontribuojnë klimës së mirë në shkollë.</p> <p>2. Mbajtja e testeve, kuzieve dhe garave të ndryshme sjellë arritjen e kompetencave kryesore.</p> <p>3. Libra të mjaftueshëm, tituj të ndryshëm, dhe klubet brenda shkollës janë funksionale.</p> <p>4. Klubet e ndryshme aktive brenda shkollës . (Klubi i gjelber, Klubi i ndermjetesimit, Klubi medial, Klubi i robotikes, Klubi i karrieres, Klubi i teatral...)</p>	<p>1. Mospërfillja i nje pjese të nxënësve për pjesëmarrje në proceset demokratike të shkollës.</p> <p>2. Mungesa e kapaciteteve teknike, digjitale të matjes së performances.</p> <p>3. Mungesa e hapësirave për punë për klubet përkatëse</p> <p>4. Mos vetëdijësimi dhe vullneti i të gjithë nxënësve dhe komunitetit për t'u marrë me punë vullnetare.</p>	<p>1. Mbajtja e seancave informuese, organizimi i debateve dhe manifestimi i festave në theks të vecantë: Dita e Fëmijëve dhe Dita e Vajzave që kanë të bëjnë me diversitetin shoqëror</p> <p>2. Mundësia e shprehjes së njohurive të përfituara nga faza përgatitore e testeve, kuizeve dhe garave</p> <p>3. Të frymëzohen nxënësit për pjesëmarrje aktive duke zhvilluar të lexuarit e rrjedhshëm dhe të menduarit kritik përmes Audio-book. Organizmi i turnirit në futboll për vajza</p> <p>4. Vetëdijësim dhe ndergjegjesim</p>	<p>1. Diskriminimet me baze gjinore.</p> <p>2. Gjetja dhe shpërndarja e pyetësorëve paraprakisht , si dhe bashkëpunimi i nxënësve dhe mësimitdhënësve jo profesional gjatë vlerësimit. Pritshmërtë e larta dhe arritjet e vogla shkaktojnë demotivim të madh të nxënësit dhe mësimitdhënësit.</p> <p>3. Dëmtimi i paisjeve dhe pakujdesia e nxënësve.</p> <p>4. Papërgjegjësia ndaj obligimeve të marra.</p>

Plotësoni fushat në tabelë dhe rrumbullako të paktën tri prioritetet kryesore, në të cilat ju dëshironi të punoni.



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



### III. FAZAT E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË SHKOLLËS

#### 3.4. Objektivat zhvillimore të shkollës

Objektivat zhvillimore të shkollës prezantohen dhe përshkruhen. Këto objektiva janë specifike për shkollën por gjithëashtu në mënyrë të qartë të lidhura dhe në korrelacion të drejtpërdrejtë me objektivat Zhvillimore Komunale të Arsimit të theksuara në PZHKA të komunës përkatëse.

Interesi kombëtar – Objektiva e marrë nga MASHT	
1	Sigurimi i cilësisë- OS 3
	Mësimdhënia dhe të nxënit - OS 5

Interesi Komunal – Objektiva e marrë nga PZHKA	
1	Ngritje e cilësisë dhe gjithëpërfshirje në arsimin fillor- O3
	Ndërtimi i mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve- O4

Interesi i shkollës – Objektiva e marrë nga Shkolla	
1	Fuqizim i aktiveve profesionale të shkollës
2	Inkurajimi i mësimin praktik dhe hulumtues duke krijuar nxënës të mirinformuar dhe qytetar të përgjegjshëm
3	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional në koherencë me të mesuarit gjatë gjithë jetës
<b>Bazuar në fushat e rrumbullakuara nën 3.2 por të transferuara në Objektiva Realiste</b>	



**SHËNIM:** Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për përgatitjet e planit të ri zhvillimor dhe planifikimin e buxhetit përkatës për një vit shkollor. Të dhënat e detajuara për kategoritë e mësipërme, si dhe kategoritë tjera relevante, janë paraqitur në Shtojcën 1 – të dhënat nga SMIA.



## IV. PLANI I MENAXHIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS – PLANI TRE VJEÇAR

### 4.1. Prioritet e përzgjedhura – arsyeshmëria

(**kriteret:** rëndësia, mundësia për të përmirësuar cilësinë e punës në shkollë, urgjenca, kapacitetet për implementim dhe qëndrueshmëria) përfshirë planin e veprimit nga komunitetet e të mësuarit së bashku (PV i KMS)

Nr.	Fushat e Cilësisë (A-E)	Renditja e të gjitha objektivave <sup>6</sup>	Arsyeshmëria për prioritetet e përzgjedhura bazuar në SWOT, PSAK, PZHKA dhe PV i KMS
